



Nr. 7589/12 prot.

Tiranë, më 29.10.2022

## DEKLARATË MJEDISORE

*për Vlerësimin Strategjik Mjedisor*

Në mbështetje të nenit nr. 12 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

### PLANI I MENAXHIMIT TE BASENIT UJOR TE LUMIT ISHEM

Kufijtë e zonës që mbulon Plani: Baseni Ujor Ishëm, me sipërfaqe prej 721 km<sup>2</sup>.

Autoriteti propozues: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

#### Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

#### Qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimin:

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapsinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, Plani në tërësi, si dhe të gjitha praktikat që do të realizohen janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor (PMBU) Ishëm ndjek pothuajse të njëjtat linja në propozime me Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore. Pra, PMBU Ishëm ka hartuar kryesisht alternativa me qëllim mbrojtjen e komponntëve të sotëm mjedisorë në disa zona të caktuara.

#### Përputhja e PMBU Ishëm të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin mjedisor:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe plotëson kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, si ai për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura, për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së së ujrave, menaxhimin e integruar të mbetjeve, ndryshimet klimatike, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave etj.

Gjatë hartimit të propozimeve nga PMBU Ishëm, i është dhënë rëndësi e veçantë shmangies së infrastrukturës masive për shfrytëzimin e burimeve ujore të këtij baseni në zonat e mbrojtura, zonat e ndjeshme mjedisore, dritaret hidrologjike dhe zonave sanitare për ujin e pijshëm.

Rekomandimet e praqitura në draftin e PMBU Ishëm kanë një perspektivë më të gjatë se afati i këtij cikli të planit dhe do të duhen disa vite për tu zbatuar dhe për të marrë efektin e disa aspekteve.

Objektivat mjedisore për basenin ujor të Ishmit janë:

- Parandalimi i përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të të gjithë trupave ujorë nga statusi aktual ose potencial;



- Kur trupat ujorë nuk e kalojnë dot testin e “statusit të mirë” ose rrezikojnë të mos i përmbushin objektivat, duhen ndërmarrë masa korrigjuese me qëllim forcimin dhe rikthimin e të gjithë trupave ujorë në “status të mirë” ose në “potencialin e mirë”;
- Trupat ujorë artificialë dhe tepër të modifikuar mund t’u nënshtrohen objektivave mjedisore më pak të rrepta për “statusin e mirë ekologjik” dhe “potencialin e mirë ekologjik”, me kusht që në planin e menaxhimit të basenit ujor të parashtrohen arsyet dhe argumentet teknike dhe/ose ekonomike.
- Substancat prioritare dhe substancat prioritare të rrezikshme që shkarkohen në mjedis duhen asgjësuar në mënyrë progresive.

Prioritetet dhe objektivat pritet të ndihmojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe në inkurajimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike përfshijnë rritjen e qëndrueshmërisë së furnizimit me energji dhe infrastrukturës së furnizimit me energji, duke rishikuar ndryshimet klimatike dhe ngjarjet ekstreme të motit në burimet ujore dhe duke zbatuar Strategjinë për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Masat Zbutëse.

### Objektivat strategjikë mjedisorë

- **Objektivi strategjik mjedisor 1:** Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.
- **Objektivi strategjik mjedisor 2:** Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore.
- **Objektivi strategjik mjedisor 3:** Mbrojtja e ujërave nëntokësore.
- **Objektivi strategjik mjedisor 4:** Cilësia e ajrit.
- **Objektivi strategjik mjedisor 5:** Shëndeti publik.
- **Objektivi strategjik mjedisor 6:** Habitatet, biodiversiteti dhe zonat e Mbrojtura.
- **Objektivi strategjik mjedisor 7:** Tokat dhe burimet tokësore.
- **Objektivi strategjik mjedisor 8:** Menaxhimi i zonës bregdetare.
- **Objektivi strategjik mjedisor 9:** Trashëgimi kulturore dhe peisazhet.

### Arsyetimi se si janë marrë në konsideratë mendimet e publikut për pasojat në mjedis të Planit të propozuar:

Në takimet e organizuara me publikun dhe palët e përfshira në procesin e VSM-së dhe vetë dokumentin e PMBU Ishëm, ka rezultuar se ky projekt-plan është pritur me pozitivitet nga komuniteti dhe grupet e interesit.

Përveç përfshirjes së institucioneve në nivel qendror, që janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe për sektorin e planifikimit të territorit, janë përfshirë edhe institucionet për zbatimin e politikave për sektorin e menaxhimit të ujërave, mbetjeve, si dhe ato të planifikimit të transportit. Pjesë e rëndësishme e procesit të konsultimit kanë qenë edhe pëfaqësues të stafit të bashkisë Durrës, bashkisë Kamëz, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pëfaqësues të organizatave joqeveritare, ekspertë të fushave të ndryshme, etj.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e PMBU Ishëm pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatëse. Komentet e grupeve të interesit janë marrë parasysh kryesisht në përcaktimin e masave zbutëse për zbatimin e planit.



### Ndikimet e mundshme në mjedis të PMBU Ishëm:

Ndryshe nga shumë plane dhe strategji sektoriale për zhvillimin kombëtar, PMBU-të nuk pritet të ndikojnë negativisht në mjedis. Përkundrazi, PMBU-të në fakt përcaktojnë objektivat mjedisore, të cilat duhet të respektojnë edhe sektorët e tjerë.

- Efekte të përziera ose të padëshiruara mund të sjellin strukturat mbrojtëse të lumenjve apo përgjatë vijës bregdetare duke kufizuar aksesin ekzistues nëpërmjet ndërtimit të tyre, por nga ana tjetër edhe duke formalizuar dhe mbrojtur monopetet.
- Ndikimet nga ndryshimet klimatike në biodiversitet dhe në burimet ujore (tharje e ujrave sipërfaqësor, erosion, etj);
- Presionet mbi ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore që vijnë nga ndotja urbane dhe industriale (ujrat e ndotura dhe mbetjet e ngurta);
- Modifikimet hidromorfologjike nga aktivitetet minerare për nxjerrjen e zhavorrit aluvial dhe kanalizimet që kanë modifikuar rrjedhjet e mesme të lumit të Tiranës dhe lumit të Tërkuzës (zona e Zallherit) në basenin e lumit Ishëm;
- Presionet mbi regjimet e rrjedhës së ujërave sipërfaqësore nga instalimet e rregulluara bujqësore dhe hidroenergjetike (humbjet e ujit përgjatë lumit të Tërkuzës deri në Bovillë arrijnë masën 60%).
- Ndërtimi i strukturave të reja mbrojtëse lumore sjell impakte negative në humbjen apo degradimin e habitateve që kanë vlerë të lartë të biodiversitetit.
- Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës, adoptimi i një sistemi të lëvizshëm të mbrojtjes, pastrimi i kanaleve të rrjedhjes së ujit, eliminimi i ngushtimeve apo hapësirave të ngushta në lumenj, mbrojtja e objekteve mund të shkaktojnë ndikim të konsiderueshëm negativ në cilësinë e tokës. Gjithashtu mund të shkaktojë humbje të sipërfaqeve të vogla të tokës dhe potencial për erozion.
- Ndryshimet në sasinë e ujit apo të rrjedhës natyrore identifikojnë efekte të mundshme pozitive për përmirësimin nëpërmjet menaxhimit të përmytjeve, vecanërisht në zonat ku trupat ujorë vlerësohen si të dëmtuar për shkak të gjëndjes së tyre fizike.
- Ndryshime apo dëmtime në cilësinë e ujit, nga fragmentimi i habitateve natyrore dhe dëmtimi i jetës së egër si pasojë e mbishfrytëzimit të prodhimit të energjisë (HEC-eve) apo keqmenaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe shkarkimi të pakontrolluar të ujrave të ndotur.

### Masat zbutëse që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të PMBU Ishëm:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të projekt-planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Masat e propozuara dhe aktivitetet e parashikuara në PMBU Ishëm të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave, në të cilat shtrihet plani dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Gjatë planifikimit të projekteve duhet t'i jepet përparësi rindërtimit të infrastrukturave ekzistuese para ndërtimeve të reja.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmytjeve).
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden në territoret ku do të zbatohet ky plan.
- Projektet që do të shfrytëzojnë burimet ujore nuk duhet të çenojnë statusin ekologjik të rrjedhave ujore apo nuk mund të zhvillojnë aktivitete që reduktojnë zonat e mbajtjes së ujit dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.



- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve apo planeve specifike individuale të Planit, duhet të përfshihen masa që do të mundësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore, sidomos në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zona të mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices”. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje.
- Plani duhet të nxisë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujrave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.
- Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- Përpara fillimit të zbatimit të planit, të hartohet studim i detajuar i basenit në këndvështrimin e shfrytëzimit të burimeve ujore për projektet hidroteknike, si dhe të miratohet harta ku mund të zhvillohen projekte hidroteknike dhe ku jo.
- Nëse pasojat në mjedis dhe shëndet, tejkalojnë standartet mjedisore në fuqi, atëherë ministria merr masat e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative ose të vlerësohet edhe ndryshimi i PMBU Ishëm me qëllim që të përmbushen standartet mjedisore.
- Nëse Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e planit vlerëson se gjatë zbatimit të tij, mund të ketë mundësi reale për të ndikuar negativisht në mjedisin e shteteve fqinje apo ka të dhëna për ndikime konkrete dhe pasoja në mjedis për atë shtet, atëherë të njoftojë menjëherë Ministrinë përgjegjëse për mjedisin, që të nisin procesin dhe konsultimin palën e prekur nga ky plan dhe të ndërpresë zbatimin e tij deri në përfundim të konsultimeve ndërkufitare.
- Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore.

Kërkesat për monitorimin mjedisor raportimin periodik në ministri gjatë zbatimit të Planit:

- Nëse PMBU Ishëm, nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëhere deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e vet-qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tij dhe nuk respekton kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëhere ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për



zbatimin e miratimin e planit dhe sipas rrethanave dhe i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të Planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky program të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të Planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të këtij Plani.

#### Kërkesa për raportim mjedisor periodik

- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masat e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.
- Autoriteti përgjegjës, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm, duhet të hartojë periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta depozitojë pranë Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin, jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

MINISTËR



Mirela KUMBARO FURXHI